



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

### PROCESVERBAL<sup>1</sup>

*(I përmbledhur)*

Tiranë, më 04.09.2019, ora 14.00

**Drejton mbledhjen**

**Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit**

#### **Rendi i Ditës :**

*1. Pyetje dhe sqarime drejtuar ekspertit, lidhur me mendimet e dhëna në aktin e ekspertimit për rastin e verifikimit të kandidaturës së Znj. Zhaklina Peto.*

#### **Marrin pjesë :**

- |                     |                     |
|---------------------|---------------------|
| 1. Ardian Dvorani   | (kryetar)           |
| 2. Vitore Tusha     | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku       | (anëtare)           |
| 4. Fatri Islamaj    | (anëtar)            |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare)           |
| 6. Fatjona Memçaj   | (anëtare)           |
| 7. Eriol Roshi      | (anëtar)            |

#### **Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :**

1. Enio Haxhimihali, përfaqësues i Avokatit të Popullit.

#### **Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr.115/2016:**

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

<sup>1</sup> Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

## HAPET MBLEDHJA

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani**, deklaroi të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

**Ardian Dvorani** lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

*Pyetje dhe sqarime drejtuar ekspertit, lidhur me mendimet e dhëna në aktin e ekspertimit për rastin e verifikimit të kandidaturës së Znj. Zhaklina Peto.*

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

**Anëtarët e Këshillit** miratojnë rendin e ditës së programuar.

**Këshilli vijon mbledhjen** më çështjen e caktuar në rendin e ditës.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** informon se eksperti jemi të informuar që është paraqitur dhe pret që ta thërrasim në mbledhje. Po kështu, kandidatja Zhaklina Peto në përgjigje njoftimit të dërguar me email nga ana jonë për zhvillimin mbledhjes së djeshme, ndonëse ato janë bërë edhe publike, ka falënderuar Këshillin për komunikimin dhe ka parashtruar katër çështje të cilësuar si pyetje të natyrës sqaruese, për të cilat janë njoftuar të gjithë pjesëmarrësit. Shtrohet pyetja nëse jeni dakord të vijojmë duke thirrur ekspertin?

**Eriol Roshi**, në cilësinë e anëtarit relator për njërin nga vendet vakante ku ka kandiduar kandidatja Zhaklina Peto, merr fjalën dhe parashtron se vetëm një nga çështjet që ngre është si kërkesë në fakt, që të merret dhe prova me ekspert në fushën topo-gjeodezisë, me topograf, tek pika e tretë pavarësisht se e ka numërtuar dy, për tu sqaruar problemi i vendndodhjes hartografike të objektit të dhënë me qera nga subjekti. Më duket se është një kërkesë e re dhe nuk ka lidhje me ekspertin kontabël, e cila mendoj se duhet trajtuar nga Këshilli.

**Anëtarët e Këshillit** vlerësuan të vijohet njëherë me thirrjen dhe zhvillimin e seancës me audituesin ligjor.

**Thirret dhe paraqitet audituesi ligjor Arqile Mishtaku, i caktuar nga Këshilli si ekspert në rastin e gjetjeve mbi pasurinë e kandidates Zhaklina Peto.**

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** informon ekspertin Arqile Mishtaku se sikurse ju kemi komunikuar, qëllimi i thirrjes tuaj sot është për të proceduar në seancë me përgjigjet tuaja eventuale lidhur me pyetjet e natyrës sqaruese eventuale të cilat kanë të bëjnë me veprimin e ekspertimit që realizoi Këshilli për kandidaten Zhaklina Peto. Për këtë rast jeni caktuar ekspert dhe keni përgatitur raportin përkatës. Por pasi Gjykata Administrative e Apelit ka shfuqizuar dy vendimet tona, ndër të tjera ka përcaktuar si një orientim, mundësinë e Këshillit për të zhvilluar një seancë sqaruese apo shpjegimesh me ekspertin. Prandaj kërkohet që fillimisht të na bëni një parashtrim të përmbledhur të mënyrës se si i jeni qasur realizimit të ekspertimit.

**Arqile Mishtaku**, merr fjalën dhe pasi falënderon Këshillin për besimin për të dhënë opinione profesionale lidhur me deklaratën e pasurisë së kandidatës znj. Zhaklina Peto, parashtron se jam munduar që brenda dokumenteve që janë paraqitur në dosje nga ILDKP dhe nga vetë kandidatja, të jap opinionin tim edhe lidhur me pyetjet e parashtruara për ekspertimin dhe për pyetjet shtesë më janë relatuar nga ana juaj....

**Anëtarët e Këshillit** orientojnë ekspertin që të parashtojë mendimet e tij duke i dhënë përgjigje pyetjeve shtesë që janë paraqitur nga kandidatja Zhaklina Peto, duke i lidhur me mendimet e dhëna deri më tani në aktin e tij të ekspertimit.

**Arqile Mishtaku**, merr fjalën dhe parashtron se duke qene se është ezauruar pyetja “ a”, është lënë që të saktësohet vetëm pika 3 e pyetjes “a”, për të saktësuar lidhur me informacionin për sipërfaqen e objektit të prej 130 m2. Normalisht ne jemi bazuar tek dokumentacioni, pra jemi bazuar në certifikatën pronës ku është shënuar 130.3 m2, por do të doja të theksoja në fillim që në kontratën që është hartuar në vitin 2000, kontrata me nr. .... e datës 17 Mars, është përcaktuar që blerja e apartamentit është 130 m2 plus tarracën. Mbi këtë bazë ne kemi vlerësuar pjesën e apartamentit dhe nuk mund të vlerësojmë tarracën. Pra në kontrata është shënuar vetëm apartamenti, në katin e 3 dhe është shënuar aty në kontrate edhe tarracë. Mbi këtë bazë e mbi dokumentet që kemi gjetur në dosjen e ILDKP ekziston dhe deklarimi i pasurisë tek ALUIZNI. Por aty nuk ka ndonjë preventiv apo situacion nga vetëdeklaruesi apo nga vetë institucioni lidhur me pjesën tjetër që është ngritur mbi tarracë. Duke qenë që nga ana e ILDKP janë krijuar dyshime lidhur me çmimin, i jemi referuar dy vendimeve që ndodhen aktualisht në faqen zyrtare të EKB-së, pra VKM të vitit 1999 dhe 2000. VKM i vitit 1999 në pikën 5 përcakton që në rrethin e Tiranës nuk ka informacion nga institucionet përkatëse në lidhur me çmimet e tregut dhe as për kostot e ndërtimit të apartamenteve në të gjithë Tiranën, aq me tepër ne zonën nr. .... që i ka qenë ky apartament. Në vitin 2000 ka përcaktime dhe kështu që ne e kemi përcaktuar saktë, duke qenë që i jemi referuar këtij vendimi. Çmimi ose kosto ndërtimore, sepse s’ka patur përsëri informacion mbi çmimet, rezulton nga 29.800 në 33.950 dhe ne e kemi llogaritur mbi sipërfaqen 130.3 m2, për aq sa përmban dosja. Pra nuk kemi informacione të mëtejshme në dosje, as nga ILDKPI-ja, që ne të formojmë një opinion më të qartë dhe analizë më të thelluar mbi këtë. Çmimi dhe vlera e kësaj pasurie qëndron mbi këto dokumente dhe në këtë vlerë.

Lidhur me pyetjen e dytë, është kaluar nga “a” të “c” dhe “b”-ja, faktikisht bëmë dhe “a”, “b”-“d” e kemi bërë bashkë për shkak se ILDKPI-ja nuk ka bërë një analizë ekonomiko-financiare të të dhënave, por është bazuar mbi bazën e konfirmimeve zyrtare të institucioneve ligjzbatuese. Ne kemi marrë dhe të gjithë *statement* e bankave nga viti 2005-2019, pasi është i vetmi informacion që jep në mënyrë të detajuar të gjitha të ardhurat e krijuara nga subjekti, nga kandidatja por edhe nga personat e lidhur familjare me të, dhe mbi këtë bazë kemi analizuar të gjithë informacionin e marrë

nga banka nga vetë ky institucion, kemi nxjerrë nga analizat edhe të ardhura të krijuar jo vetëm nga pagat por dhe burime të tjera dhe kemi arritur në rezultatin që ne kemi paraqitur në pasqyrat në mënyrë të detajuar në raport. Na është kërkuar që ne ti bënim të veçanta, por për shkak se për ndërtimin e një pasqyre financiare ndër vite, përveç burimit të ardhurave që kërkon pasqyra, transaksionet e pasurisë në zbritje apo në shtesë apo detyrime të tjera borxhe pozitive apo negative dhe shpenzimet jetike, ne na duhet dhe gjendja e *cash-it* ose e mjeteve monetare në fund të vitit, për të cilin subjekti nuk e ka patur detyrimin nga ligji sepse nuk ka deklaruar në ILDKP dhe s`mund ta jepte këtë informacion. Në këto kushte ne kemi bërë pasqyrën ekonomiko-financiare, pra buxhetin familjar të kandidatit nga viti 2005 deri në mars të 2018 në total dhe rezultatin e kemi paraqitur tek pjesa e raportit në mënyrë të përmbledhur. Shpresoj kjo është gjithë mendimi që kemi dhënë bazuar në dokumente. Nëse do të ketë dokumente të tjera shtesë, ne jemi të gatshëm që të operojmë por edhe të japim konkluzione të mëtejshme. Ju faleminderit.

**Fatri Islamaj**, merr fjalën dhe shtron pyetjes se, duke e parë të arsyeshme, do ti drejtoja një pyetje ekspertit në lidhje me kategorinë e licencës për të cilën ju jeni i licencuar. Ju vërtet jeni thirrur si ekspert kontabël dhe që e gëzoni këtë licencë kjo është e verifikuar. Doja të pyesja a e keni licencën e ekspertit vlerësues të pasurive të paluajtshme? Sepse në shumë raste ekspertet kontabël e kanë marrë edhe atë.

**Arqile Mishtaku**, merr fjalën dhe përgjigjet se nuk e kam këtë licence. Kam vetëm të ekspertit kontabël, pra të audituesit ligjor. Kam 20 vjet në këtë profesion.

**Fatri Islamaj**, merr fjalën dhe shprehet se kjo ishte më shumë për të vlerësuar nëse ju do të kishit mundësi për të dhënë opinion për vlerën e atyre sipërfaqeve të cilët ju thate janë të shënuara si tarracë, për problemet në kontratën e blerjes së pasurisë, por që ILDKP-ja i ka konsideruar si gjetje për një sipërfaqe prej 53.6 m2 shtesë dhe verandë 64 m2. Nëse ju do kishit licencë si vlerësues i pasurisë së paluajtshme, ndoshta mund të kishit dhënë një opinion. Dakord, në rregull.

**Arqile Mishtaku**, merr fjalën dhe shprehet se nëse me lejoni mund të shpjegojem. Pjesa tjetër është pjesë e kontratës së AILUIZNIT në të cilin është deklaruar, nëse i referohemi çmimit minimal ose kosto minimale fiskale të Tiranës, është 30 mijë lekë m2, kosto minimale, pastaj çmimi është diku më lart. Vetëm ky fakt mund të shërbejë si opinion për të vlerësuar më tej. Faleminderit.

**Margarita Buhali**, merr fjalën dhe shprehet se meqenëse jemi këtu, në rast se tek sipërfaqja 130 m2 që është pretenduar si e blerë nga subjekti, do të shtojmë dhe sipërfaqen prej 53,6 m2 që vetë subjekti pretendon se ka qenë ndërtuar nga shitësi, por që në fakt nuk gjendet në kontratë. Duke e marrë të mirëqenë këtë deklaram të saj që kemi edhe një shtesë kati prej 53.6 m2, atëherë sa do të shkonte vlera e gjithë këtij ndërtimi me koston minimale?

**Arqile Mishtaku**, merr fjalën dhe duke e falënderuar për pyetjen përgjigjet se normalisht jemi bazuar në dy vendimet e Këshillit të Ministrave dhe kemi nxjerrë një kosto ndërtimore, e cila lëviz nga 29 deri 33 mijë lekë për m<sup>2</sup>, dhe për 3.9 milion lekë i bie diku tek 130 m<sup>2</sup> ndërtesë shfrytëzimi. Nëse do të ishte diçka në metra katror më shumë normalisht që çmimi do të ndryshonte.

**Margarita Buhali**, merr fjalën dhe shtron pyetjen meqenëse do të ndryshonte, atëherë sa, sepse janë 53.6 m<sup>2</sup> që pretendohet se janë më shume dhe që vetë subjekti e pranon vetë që e ka ndërtuar? Si del kjo në raport me çmimin minimal? Do ti shtohet çmimit?

**Arqile Mishtaku**, merr fjalën dhe përgjigjet se 53.6 herë 33 mijë del më shumë normalisht. Patjetër që mund ti shtohet çmimit. Ne jemi bazuar tek dokumentacioni. Pra çmimi minimal në të dy vendimet e Këshillit të Ministrave është nga 29 në 33 mijë lekë. Nga deklarimi, nga dokumentat e deklaruara, është 133 m<sup>2</sup>, edhe në certifikatën e pronës është 133.3 m<sup>2</sup>. Nëse do ti shtojmë metrat katror, normalisht çmimi del më i ulët. Çmimi nuk ndryshon, ndryshon vlera e apartamentit që do të ishte më e lartë.

**Margarita Buhali**, merr fjalën dhe shtron pyetjen, ju për tabelat tuaja, e sqaruar edhe paraprakisht që jeni marrë me të ardhurat e deklaruara në vite subjekti, pasi nuk kishit gjendje *cash* të deklaruar nga kursimet ndër vite. Duke pasur në konsideratë që pasuritë e deklaruara nga subjekti janë blerë në vite të ndryshme dhe duke pasur gjithashtu në konsideratë raportin midis shpenzimeve edhe të ardhurave në vitin, mund të japim një shpjegim nëse mundesh si del deri në atë vit? Sepse p.sh ajo ka blerë në vitin 2009 një pasuri 110 m<sup>2</sup>, në vlerën 96 mijë euro. Pjesërisht ka deklaruar që e ka marrë me kredi. Në dosje janë dokumentet, atëherë, pjesa tjetër tej kredisë mbulohej nga subjekti, deri në vitin 2010 – 2019 që ka blerë këtë pasuri?

**Arqile Mishtaku**, merr fjalën dhe përgjigjet se për këtë është dhënë përgjigje tek pika c e aktit të ekspeditimit, në faqet 4, 5, 6, 7. Dhe kemi dhënë analizën për vitet 1996-2010, pasi kemi patur një bazë e të dhënave dhe të ardhurave ose të cash-it në llogaritë bankare. Nuk kemi patur të cash-it personal, pra të cash-it familjar. Për shkak se ne nuk kemi cash-in familjar dhe subjekti nuk e ka pasur detyrim të deklaronte sepse nuk ka qenë subjekt i deklarimit në ILDKP, normalisht opinionin jonë do të ishte një opinion jo i saktë sepse nuk kemi cash-in. Nëse do ta kishim për çdo vit, ne do ta nxirrnim këtë informacion. Por ne e kemi bërë për vitin 1996 – 2010 dhe të ardhurat mbulojnë të gjitha, pasuria, transaksionet e pasurisë që ka fituar subjekti po dhe së bashku me personat e lidhur. Duke zbritur shpenzimet jetike ose çdo lloj detyrimi tjetër, dhe duke zbritur gjendjen në llogarinë bankare tek pasqyra, pika 7, pra, një gjendje prej 150 mijë lekësh 585, rezulton një gjendje pozitive e të ardhurave të saj prej 6 milion lekësh. Po përsëri po them, ne këtu nuk kemi të deklaruar cash-in në familje. Nëse do ta normalisht të ardhurat do të ishin më shumë. Pot nga ky vit deri në 2010, të gjitha transaksionet që janë kryer janë me burime të justifikuara nga të ardhurat. Unë theksoj këtu edhe

diçka tjetër sepse prandaj i jemi futur pjesës së bankave, për arsye sepse jo të gjitha institucionet e japin informacionin e duhur, në rastin kur një subjekt krijon të ardhura. Një fakt shumë të thjeshtë. Listëpagesat e punonjësve kanë afate sa mbahen dhe çdo institucion e ka për detyrë të mbaj një listëpagesat dhe të ardhurat e secilit prej punonjësve, kurse të ardhurat që përfitojnë punonjësit në rastin e honorarëve, ato nuk janë të kontabilizuara në mënyrë individuale për secilin që i merr, por ato mbahen brenda në llogaritë e secilit institucion, por kush është i interesuar, duhet të shkojë të marri vërtetim sepse nuk i del më si burim të të ardhurash. Prandaj, dhe unë i jam futur bankës sepse vetëm banka është ajo që ka arkëtuar. Edhe këtu është ajo pjesa e institucioneve që e kanë dhënë këtë honorar në bankë, nëse e kanë dhënë cash përsëri kjo nuk mund të gjendet. Dhe prandaj të ardhurat janë disi më të larta se sa janë deklaruar nga ILDKP-ja. Dhe ne i jemi futur të gjithave të ardhurave e burimeve nga bankat dhe dalin të gjitha të ardhurat më lart, por më kryesisht tek bashkëshorti ku janë rreth 4.5 milion lekë më shumë sesa ka gjetur ILDKP-ja. Pra, ILDKP-ja është mbështetur vetëm tek pjesa e vërtetimeve konfirmuese dhe jo tek analiza e bankave që ne këtu i jemi futur dhe kemi gjetur këtë rezultat. Shpresoj që të jem i qartë për pyetjen.

**Margarita Buhali**, merr fjalën dhe shtron pyetjen se meqenëse e keni filluar me detaje, a ka pasur të ardhura subjekti mbi 2 milion lekë për një vit, në vitet financiare dhe nëse ka, a ka pasur deklarime të tilla nëpër dosjet që ju keni parë, nga subjekti ose nga bashkëshorti i saj ?

**Arqile Mishtaku**, merr fjalën dhe përgjigjet se këto i keni të detajuara tek faqja 8, janë të deklaruar të gjitha të ardhurat që ka fituar.....

**Margarita Buhali**, ndërhyt dhe shtron pyetjen se atëherë rezulton që mund të ketë, që ka të ardhura mbi 2 milion ? Të paktën unë po shikoj 2011 ose 2012.

**Arqile Mishtaku**, merr fjalën dhe përgjigjet se për vitin 2011, po ka mbi 2 milion. Këtu i ke në mënyrë të detajuara të gjitha të ardhurat nga bankat.

**Margarita Buhali**, ndërhyt dhe shtron pyetjen se deklarime të DIVA-s ka pasur në dosjen që ju keni parë? Pra të DIVA-s ku deklarohen nga subjektet vlerat mbi 2 milion të të ardhurave personale ?

**Arqile Mishtaku**, merr fjalën dhe përgjigjet se po ka patur, tek pjesa e ILDKP-së. Unë nuk i jam futur pjesës së DIVA-s sepse nuk është ajo pjesë .....

**Margarita Buhali**, ndërhyt dhe shtron pyetjen se domethënë të ardhurat që ka pasur subjekti tek DIVA në raport me këtë, a janë verifikuar këto në bankë, për efekt të të ardhurave në ndryshimin e ILDKPI-së?

**Arqile Mishtaku**, merr fjalën dhe përgjigjet se nuk ka qenë pjesë e verifikimit të të ardhurave se si i ka deklaruar ajo, mirë apo keq tek DIVA, nuk i jam futur por nëse do të duhet unë i futem

dhe.... (ndërhyrje pa mikrofon), por unë thjesht i kam bërë në mënyrë analitike 8, 9,10, 11 tek të gjitha të ardhurat në mënyrë analitike nga të gjitha bankat.

**Margarita Buhali**, ndërhyr dhe shprehet në rregull, jo e kisha më shumë në kuadër të shpenzimeve. Në qoftë se ajo ka bërë deklarime në DIVA dhe tek DIVA-t janë mbajtur tatime mbi të ardhurat, a nuk futen këto tek shpenzimet që ulin të ardhurat reale që ka marrë subjekti?

**Arqile Mishtaku**, merr fjalën dhe përgjigjet se atëherë, pjesa e këtyre të ardhurave janë neto, sepse kanë dal të ardhura neto në bankë.....

**Margarita Buhali**, ndërhyr dhe shtron pyetjet se po në bankë, por neve paguajmë shpenzimet, domethënë në qoftë se nuk i kemi paguar të gjitha, tek institucionet nuk janë mbajtur, deklaroj për vitin tjetër dhe ajo paguhet për vitin tjetër?

**Arqile Mishtaku**, merr fjalën dhe përgjigjet se diferenca do të jetë 7 %.....

**Margarita Buhali**, ndërhyr dhe shtron pyetjet se për 7%, domethënë nuk e keni parë këtë sepse keni marrë vetëm ato që ishin gjendje në bankë, sepse ajo edhe mund të ketë tërhequr, ka shpenzuar? Sa ngelet kjo gjendje me të ardhura? Kështu keni marrë shpenzimet vetëm për jetesë?

**Arqile Mishtaku**, merr fjalën dhe përgjigjet se kemi marrë vetëm ato që ishin në bankë. Për vlerat që mund të ketë shpenzuar, atëherë ka shpenzime. I jam futur vetëm nëpërmjet raportit sasior që ka nxjerrë INSTATI, sepse jo të gjitha, edhe për shpenzimet jetike nuk mund të dalin të ardhurat, shpenzimet nga pagesat e bankave, se ajo mund të ketë dhe depozitë, këtë e përsëris. Kam kontabilizuar dhe raportuar të ardhurat neto që ka fituar subjekti dhe personat e lidhur me të.

**Enio Haxhimihali** merr fjalën dhe shprehet se ju keni bërë një akt ekspertimi mbi bazën e një dokumentacioni të vënë në dispozicion nga KED-ja. Ky dokumentacion ju është dhënë më procesverbal sepse nuk e del qartë cilat dokumenta keni parë? Si ju është vënë në dispozicion dokumentacioni? Ka një procesverbal që ju dha 10 mijë faqe, 5 mijë faqe, 100 faqe apo në çfarë mënyre?

**Arqile Mishtaku**, merr fjalën dhe përgjigjet se unë dokumentacionin e kam marrë këtu në institucion, në mënyrë elektronike dhe një pjesë të dokumenteve në mënyrë të shkruar. Por formalisht nuk i kam marrë procesverbal sepse është çështje mirëbesimi.

**Enio Haxhimihali** merr fjalën dhe shprehet se dakord, besoj që ju janë dhënë dhe këto statement të bankave. Psh. në raportin e ILDKPI-së, në faqen 96, është statement i BKT-së, që janë 66 faqe, OTP BANK faqe 201 që përsëri janë statement etj, etj. Pyetja ka të bëjë me pikën 10 të raportit tuaj, tek shpenzimet që e preku edhe kolegja pak më parë. I jeni referuar të dhënave të INSTAT-it, ndërkohë mund të lind një pyetje, a keni bërë ju një ballafaqim të shpenzimeve teorike mbi bazën e të dhënave të INSTAT-it me shpenzimet e të ardhurave reale që juve ju rezulton nga statement të bankave të ndryshme apo nuk e keni bërë? Nuk e di, a e kuptuat pyetjen?

**Arqile Mishtaku**, merr fjalën dhe përgjigjet se tek pjesa e bankës jam marrë me kreditin e bankës, statement të bankës për të nxjerrë të ardhurat e fituara në total. Dhe normalisht informacioni për pagesat ndërmjet bankës nuk mund të jetë në mënyrë të mirëfilltë dhe vetëm për pjesën e shpenzimeve. Sepse ato mund të jenë tërheqje dhe për blerje. Mund të jenë tërheqje dhe të rriten përsëri prapë. Nuk është se janë argumentuar, veprimi kontabël mungon se për çfarë është tërhequr ai shpenzim. Mund të jetë me kartë krediti, cash dhe nuk është saktësuar natyra e shpenzimit. Unë nuk mund të jap një opinion që të saktësoj dhe të klasifikoj shpenzimet sipas pagesës së bankave.

**Enio Haxhimihali** ndërhyr dhe pyet si vlerë a përputhen këto apo sa është diferenca?

**Arqile Mishtaku**, merr fjalën dhe përgjigjet se normalisht kam referuar bankat dhe kjo vlen sipas raportit por po them nuk i klasifikoj dot pagesat e bankës sipas natyrës se shpenzimit të kryer, për shkak se banka nuk e ka të referuar që kjo pagesë e sotme është marrë po themi për blerjet për një pajisje apo për shpenzime pushimi. Prandaj i jam referuar INSTAT-it. Po të shikojmë midis meje dhe ILDKPI-së, ndryshimi është diku tek 800 mijë lekë të reja. Pra, jemi pothuajse aty. Në fund ky është një opinion, këtu nuk është një rezultat financiar. Rezultati financiar del mbi veprimet kontabël dhe mbi dokumentat kontabël. Në japim një opinion financiar mbi situatën dhe dokumentat e paraqitura. Nëse do të kishim një opinion të saktë mbi rezultatin financiar ku të ketë përshkruar në mënyrë të detajuar çdo lloj veprimi të kryer nga banka apo nga subjekti deklarues. Për shkak se subjekti nuk ka qenë subjekt i nënshtruar nga ligji për deklarimin e pasurisë në vitet, normalisht opinionet do të jetë aq sa në kemi marrë informacion nga dosja. Kjo është e gjitha.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani**, merr fjalën dhe meqenëse nuk ka më pyetje falënderon ekspertin për paraqitjen dhe përgjigjet e shpjegimet e dhëna për pyetjet e drejtuara në mbledhjen e Këshillit. Ne do vijojmë, do të marrim vendimet përkatëse dhe në qoftë se, eventualisht, do të lindi nevoja për të na dhënë shpjegime etj. do të lidhemi dhe ju njoftojmë menjëherë.

**Arqile Mishtaku** merr fjalën dhe shpreh falënderimin për besimin.

**Mbledhja e Këshillit** vijon me trajtimin e pyetjes në formë kërkesë të kandidates për të saktësuar identitetin e nj pasurie të paluajtshme nëpërmjet një eksperti topograf.

**Eriol Roshi**, në cilësinë e anëtarit relator për njërin nga vendet vakante ku ka kandiduar kandidatja Zhaklina Peto, merr fjalën dhe relaton se kandidatja kërkon nga Këshilli marrjen e një prove të re, është një çështje që e ka ngritur edhe ILDKPI në raportin e saj, për një pasuri të paluajtshme apartament. Këshilli e ka trajtuar rastin dhe gjetjen herën e parë dhe ka arritur në konkluzionin që faktikisht bëhet fjalë për të njëjtën pasuri, për të njëjtën kontratë, por ndryshon referenca, adresa e rrugës ku ndodhet nëpër dokumente, prandaj krijohet një keqkuptim. Marrja e provës me ekspert topograf do të përcaktonte dhe saktësonte pikërisht këtë pretendim që Këshilli e ka pranuar se origjina e kësaj është kontrata e datës 17 mars 2000 dhe lidhja e kësaj pjesë të pasurisë



që është dhënë kompanisë private është pikërisht kjo që është bashkëpronare dhe vërtetohet nga aktet.

**Anëtarët e Këshillit** diskutojnë dhe konkludojnë unanimitisht se kjo kërkesë nuk pranohet sepse është e panevojshme marrja e provës së re me anë të një eksperti topograf për vendndodhjen e apartamentin sepse Këshilli e ka verifikuar dhe pranuar në procedurën e verifikimit dhe në vendimin e tij për këtë kandidatë se bëhet fjalë për një apartament, por që ka dy adresa të ndryshme në kontratë dhe dokumente për shkak të vendndodhjes në kryqëzim të dy rrugëve. Aq më tepër që kjo çështje nuk ka përbërë motiv për ndalimin e kandidimit në vendimet e Këshillit.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** orienton diskutimin edhe për një pyetje të katërt ku kandidatja kërkon të pyetet ILDKPI nëse një pasuri prej 130 m<sup>2</sup> është pasuri e saj apo është një gjetje e tyre si e padeklaruar prej meje. Në fakt edhe vetë kandidatja mund të na deklaronte është apo nuk është e saj.

**Anëtarët e Këshillit** diskutojnë dhe konkludojnë unanimitisht se kjo kërkesë nuk pranohet sepse është e panevojshme marrja e provës së re me anë të një eksperti topograf edhe për pasurinë tjetër apartament prej 130 m<sup>2</sup> e blerë në vitin 2000. Edhe vetë ILDKP-ja nuk e ka ngarkuar kandidaten me përgjegjësi se nuk e ka bërë deklarin për këtë pasuri por është shprehur se është e paqartë lidhja nga ka ardhur kjo pasuri që ajo e ka dhënë me qera. Pra nuk ka arritur një konkluzion kategorik në dëm të kandidatës Zhaklina Peto. Edhe Këshilli nuk ka konstatuar ndonjë parregullsi në gjetjet si edhe në shpjegimet që kandidatja ka dhënë për këtë pjesë.

**Bledar Dervishaj** kërkon fjaën dhe parashtron se unë mbajta shënim çfarë eksperti tha sot ose të paktën mua me ra në sy nga fjalët e ekspertit në shpjegimet që bëri. Thotë nuk kemi informacion më të plote nga ILDKPI-ja, vlerësimi bazohet në dokumentacionin që na është vënë në dispozicion. ILDKP, tha eksperti, nuk ka bërë një analizë financiare të pasurisë së krijuar, por i është referuar vetëm informacionit të marre në kontratë dhe hipoteka. Subjekti ka deklaruar për here të parë, nuk e ka të deklaruar cash-in në familje, mungon gjendja cash, DIVA-t - nuk i jam futur disa çështje, nuk ka bërë një kryqëzim të ardhura- shpenzime, ky i imi thotë është një opinion, do të bëja një akt ekspertimi më të plotë nëse nga ILDKPI do më jepte ndonjë informacion më të zgjeruar.

Herën e kaluar në mbledhje, unë parashtrova që, në varësi të gjetjeve, pyetje përgjigjes nga eksperti mund të lindin të dhëna nga organi burim që është ILDKPI. Madje eksperti u pyet mbi gjetjet e ILDKPI-së, edhe të vetat patjetër, por këtu më shumë del nevoja për sqarim të vetë veprimtarisë së ILDKPI-së, sepse këtu një pasuri është ajo që po qarkullon për diskutim të madh, shtesa prej 55 m<sup>2</sup>, se verandën ajo e ka të shënuar tarracë, me sa po e inventoj unë, nëse e kam gabim më korrigjoni. Kështu që unë mendoj se është vendi që ILDKPI-së ti kërkohet një shpjegim shtesë, mbi gjetjet e saj, i arsyetuar. Unë mendoj se Këshilli ka vlerësimin dhe vendimmarrjen e tij, por

është e mëse domosdoshme që ky Këshill ta pyesë ILDKP, për të marrë një opinion përfundimtar mbi gjetjet e saj se po i thuhet kandidates ik dhe unë për vete nga leximi i vendimit nuk po e kuptoj pse po ik, unë vete si jurist. Thotë ka të deklaruar, është, nuk ka deklarim jashtë kësaj që ka dhënë tek ne, por vihet në dyshim cilësia e kontratës, është e përfshirë, ka paqartësi, apo nuk është e përfshirë, ka ekzistuar si pasuri apo nuk ka ekzistuar. Ne flasim verifikimin e gjendjes së pasurisë, të kandidatit dhe të familjes. Me cilin e ka krijuar këtë pasuri? E ka blerë bashkë me këtë kryefamiljarë që ka sot? Këtë e ka verifikuar ILDKPI? Si mund të vihet në dyshim çmimi në një kontrate të para 20 viteve sepse kjo është është pak e çuditshme kur kjo nuk ka qenë subjekt dhe nuk ka pasur as qellim subjektiv që të bëj shmangie. Nuk mund të hyhet në diskutim të vullnetit të tre palëve në një kontratë dhe të mendohet sot se ka pasur deviacion në ulje çmimi. Unë nuk jam eksperti i kontabël por them që ILDKPI nevojitet të jetë më shteruese në këtë rast.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** informon se do ta kemi parasysh sugjerimin tuaj. Gjithsesi vendimi jonë, po ta vini re, bazohet në dy tre motive të tjera që nuk kanë lidhje as me aktin ekspertimit faktikisht, por kjo është një çështje që do ta rivlerësojë Këshilli. E dyta eksperti ka pasur jo vetëm dokumentacionin e ILDKPI-se, por ka pasur dhe dokumentacionin tonë. E treta ka pasur jo vetëm dokumentacionin tonë por edhe bashkë me prapësimet kandidatja ka sjellë dhe dokumente të vetat shtesë. Pra, atë tha ekspert se unë përveçse kam pasqyruar tabelë nga ILDKPI-ja kam shtuar edhe të tjera sepse i gjej tek dokumentacioni i tyre, por kam përshtypje se i kishte tek dokumentacioni jonë se edhe ne kemi një mal me dokumente të ardhur nga bankat, të cilat ai e i ka parë një me një të gjitha. Unë kam përshtypjen që ajo që tha eksperti është që ILDKPI me ato që kishte ishte bazuar mbi vërtetime institucionesh por jo tek shifrat që kishin, lëvizjet e llogarive bankare. Pra, nuk është se ka mbetur vetëm me dokumentacionet e ILDKPI sepse dosja është e trefishtë në fakt/ Këtu mua më rezulton se kemi me shumë dokumentacion se sa ata, në volum po por edhe në disa elemente. Kjo është më shumë për të shpjeguar se çfarë ka pasur eksperti në dorë. Mirë atëherë ne duhet gjithsesi të ripunojmë relacionin, edhe duke shtuar jo vetëm nga pikëpamja historikut tani, por edhe historikut që është bërë një ankim, një gjykim, vendimi i gjykatës, motivet bazë, vendimi jonë për të bërë këtë veprim që po bëjmë sot, edhe thelbin e po e quaj të bisedës së sotme ose pyetje përgjigjet me ekspertin, seanca bisedë është në fund te fundit është bisedim dhe pastaj këtë duhet tja njoftojmë kandidates.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani**, pasi merr mendimin e anëtarëve për rendin e ditës dhe kohën e mbledhjes së ardhshme, duke marrë masa të përgatitet relacioni i përditësuar dhe dërgimi i informacioneve mbi seancën e sotme kandidates, duke u përcaktuar zhvillimi i saj në datën 09.09.2019, në orën 14.00, në thelb, me rend dite edhe shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e

verifikimit të kandidatës Zhaklina Peto për kandidimin e saj për dy vende vakante për Gjykatën Kushtetuese, deklaroi mbylljen e mbledhjes.

### **MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 15.05**

**Sekretare**

**Dorina Dulaj**

**Ermelinda Kadiu**

**Kryetari**

**Ardian Dvorani**